

**VENDIM**  
**Nr. 426, datë 8.6.2016**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOZHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES  
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN, PËR INSTITUTIN E NDËRTIMIT, TIRANË,  
TË KATIT PËRDHES, ME SIPËRFAQE 681.5 m<sup>2</sup>, NË OBJEKTIN TREKATËSH,  
KOMPONENT I PRONËS NR. 90, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK  
NR. 4400 (ISH-SHTABI I KML-së)”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Urban, për Institutin e Ndërtimit, Tiranë, për një periudhë 30-vjeçare, të katit përdhes, me sipërfaqe 681.5 (gjashtëqind e tetëdhjetë e një pikë pesë) m<sup>2</sup>, në objektin trekatësh, komponent i pronës nr. 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për sistemimin e administratës së Institutit të Ndërtimit, Tiranë, me ambiente pune dhe në funksion të veprimtarisë së tij.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban i ndalohet të ndryshojë destinacionin e katit përdhes në objektin trekatësh, komponent i pronës me nr. 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400, (ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave i hiqet nga përdorimi i përkohshëm kati përdhes, në objektin trekatësh, sipas planimetrisë, komponent i pronës nr. 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (ish-Shtabi KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, miratuar me vendimin nr. 277, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të disa objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3 035.6 (tre mijë e tridhjetë e pesë pikë gjashtë) m<sup>2</sup>, brenda territorit të pronës me numër rendor 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr.4400 (ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë”.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**

PLANVENDOSJA E  
PRONES Nr.90 (ISH SHTABI I K. M. L.) TIRANE

SISTEMI I KOORDINATAVE SHITESORE

581  
350

403 950

404 000

581  
300

TIRANE

RRUGE


TUFINE


RRUGE


③  
1K

②  
1K

1K





$$\text{SIP} = 681.5 \text{ m}^2$$


|                                               |          |                              |                                                                                       |
|-----------------------------------------------|----------|------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| REP.SHQIPERISE<br>MIN. MBROJTJES<br>I.GJ.I.U. | DREJTORI | N/Kol.Ark.Ferdi <b>HYRAJ</b> |  |
| Prona nr.90<br>"Shtabi i KML", Tirane         | VIZATOI  | Top. Nikoll TUSHI            |  |
| Qershor 2016                                  | PERPILOI | Top. Edison MEMELLI          |  |